



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2018

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT, PROGRAMET DHE FINANCIMIN E SHËRBIMIT TË SPECIALIZUAR PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 84, pika 3 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, me propozim të ministrit së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e institucionit ose personit juridik të licencuar për zbatimin e masës së sigurimit për të miturin në konflikt me ligjin.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe ministria që ka në fushën e përgjegjësisë së saj mbrojtjen sociale të fëmijëve të nxjerrin udhëzim të përbashkët për procedurat dhe mënyrën e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit të ofruar nga institucioni ose personi juridik i licencuar për zbatimin e masës së sigurimit për të miturin në konflikt me ligjin.

II. RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN

1. Organizimi i shërbimit

1.1. Institucioni ose personi juridik i licencuar për ofrimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin (këtu e në vijim “*ofruesi i shërbimit të specializuar*”

për të miturit në konflikt me ligjin”) duhet të ketë një strukturë të përshtatshme të personelit në përputhje me nevojat e përfituesve të mitur.

1.2. Organigrama e ofruesit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin paraqet në mënyrë grafike të gjithë pozicionet brenda institucionit ose personit juridik të licensuar që lidhen me funksionimin e shërbimit, si dhe marrëdhëniet e varësisë dhe të mbikqyrjes administrative.

1.3. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të mbajë dosje individuale për të gjithë personelin e tij. Dosja individuale përmban dokument original ose kopje të njesuar me origjinalin të:

- i) jetëshkrimit,
- ii) diplomës të arsimimit të ndjekur;
- iii) dëshmisë penaliteti,
- iv) çertifikatës/ve profesionale,
- v) rekomandimeve të dhëna nga punëdhënës,
- vi) Përshkrimit të detyrave,
- vii) librezës së punës;
- viii) kontratës së punës,
- ix) vlerësimeve të performancës,
- x) vërtetimeve mjekësore,
- xi) çdo dokumenti/vërtetim tjetër të nevojshëm.

1.4. Për secilin pozicion, ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të hartojë përshkrimin e vendeve të punës ku përcaktohen përgjegjësitë, detyrat, arsimimi, kualifikimi. Pozicionet dhe kualifikimet duhet të përputhen me shërbimet e ofruara.

1.5. Personeli nënshkruan kontratë pune në përputhje me Kodin e Punës. Kontrata e Punës përfshin: përshkrimin e detyrave, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit, marrëdhëniet e varësisë, referencat tek rregullorja e brendshme; kodi i etikës; “Deklaratën e konfidencialitetit”, si dhe çështje të tjera që lidhen me ushtrimin e detyrës.

1.6. Personeli i shërbimit të specializuar për të miturit që vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

1.7. Detyrimet e personelit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin ndaj përfituesit duhet të afishohen në mjediset e brendshme që të gjithë përfituesit e mitur të mund t’i shohin.

1.8. Punonjësi i ri i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin i nënshtrohet një trajnimit të brendshëm për të kuptuar misionin e ofruesit të shërbimit dhe rolin e tij në ndihmën ndaj përfituesve të mitur. Çdo ofrues shërbimesh për të miturit në konflikt me ligjin duhet të ketë një program trajnimit për punonjësit e tij. Programi i trajnimit duhet të përfshijë të gjithë fushat kryesore të nevojshme të trajnimit, objektivat për secilin sesion dhe mënyrën se si do të ofrohet trajnimit.

1.9. Personeli i nënshtrohet trajnimit të vazhdueshëm profesional gjatë kohës që janë të punësuar në shërbimin e specializuar për të miturit në konflikt me ligjin.

1.10. Institucioni ose personi juridik i licensuar për ofrimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin harton rregulla të brendshme të organizimit dhe

funksionimit të shërbimit. Këto rregulla duhet të jenë të shkruara në një gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar dhe të jenë të afishuara në mjediset e shërbimit të specializuar.

2. Funksionimi i shërbimit

2.1. Qëndrimi në shërbimin e specializuar për të miturit në konflikt me ligjin caktohet nga gjykata dhe përfituesi i mituri mund të largohet vetëm në raste kur vendos gjykata.

2.2. Çdo ofrues i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin harton një formular përmbledhës njohës që përshkruan qartë misionin, objektivat e shërbimit, profilin që ka, shërbimi që ofron, struktura organike për zbatimin e programeve, detyrat dhe detyrimet e stafit, procedurat e shërbimit, mbrojtja dhe siguria e përfituesit, marrëdhënia me familjarët dhe të afërmit, procedura e ankimimit, deklarata e konfidencialitetit, referimi në një shërbim tjetër apo përfundimi i shërbimit të ofruar.

2.3. Përfituesit e mitur të shërbimit të specializuar duhet të konfirmojnë se janë njohur me formularin përmbledhës të ofruesit të shërbimit dhe kanë marrë një kopje të tij.

2.4. Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimit duhet të përcaktojë qartë se si ofrohen shërbimet drejtpërdrejt prej tij ose nëpërmjet referimit në institucionet ose organizatat e tjera.

2.5. I mituri në konflikt me ligjin, prindërit ose personi i afërt i tij duhet të nënshkruajnë deklaratën e pranimit. Në këtë mënyrë sigurohet që prindi/personi i afërt i përfituesit të mitur është plotësisht i informuar rreth shërbimit të specializuar që merr si përfitues, si dhe mbi rregullat që do të funksionojnë gjatë kohës së qëndrimit të të miturit në shërbimin e specializuar.

2.6. Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin rishikohet dhe përditësohet sa herë që ofruesi i shërbimit zgjeron aktivitetin e tij, por që asnjëherë nuk del jashtë objektit të licensimit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

2.7. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin hartojnë dokumentacion të qartë të të drejtave të përfituesit të shërbimit të specializuar. Këto të drejta duhet të jenë të shkruara në gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Të drejtat duhet të përfshijnë minimalisht të drejtën për t'u trajtuar në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, me respekt dhe dinjitet, të drejtën për t'u dëgjuar dhe shprehur mendimet, të drejtën për t'u ankuar pa patur frikën e pasojave negative.

2.8. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të shkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e përfituesit. Këto detyrime duhet të jenë të shkruara në një gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Ato duhet të përfshijnë të gjithë detyrimet që ka përfituesi kur merr pjesë në programin e ofruesit të shërbimit të specializuar.

2.9. Të gjithë dokumentet e mësipërme, përfshirë të drejtat e përfituesit, detyrat dhe përgjegjësitë e përfituesit, duhet të afishohen në mjediset e shërbimit të specializuar dhe që mund të shihen dhe lexohen lehtësisht nga përfituesit dhe personeli.

2.10. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të përfshijnë përfituesin në funksionimin e shërbimit dhe në vendimmarrjen që lidhet me jetën e përditshme në të. Përfituesi nxitet të japë mendime për shërbimet dhe rregullat e vendosura, oraret, cilësinë e shërbimit, si dhe për elementë të tjerë që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shërbimit të ofruar.

3. Administrimi i të dhënave personale të të miturit përfitues

3.1. Për secilin përfitues të mitur që qëndron në shërbimin e specializuar të të miturit në konflikt me ligjin, ofruesi duhet të krijojë dhe të administrojë një dosje individuale. Administrimi i dokumentacionit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3.2. Të dhënat e dokumentacionit të përfituesit duhet të jenë konfidenciale. Dokumentacioni mbahet në një vend të sigurtë. Dokumentacioni aksesohet vetëm nga prokurori, gjyqtari, menaxheri i rastit, drejtuesi i shërbimit vetëm për qëllime në interes të të miturit, i mituri përfitues, prindërit apo personi i afërt i tij.

3.3. Ofruesi i shërbimit të specializuar të të miturit në konflikt me ligjin duhet të mbrojë të gjitha të dhënat personale të përfituesit. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të sigurojë që dosjet e printuara dhe dosjet elektronike me të dhëna të ruhen të sigurta. Për dosjet e printuara, kjo duhet të bëhet nëpërmjet ruajtjes së dosjeve në raftet të mbyllura me çelës në një dhomë që është e kyçur. Për dosjet elektronike, ato duhet të ruhen me fjalëkalim.

3.4. Ofruesi i shërbimit të specializuar të të miturit në konflikt me ligjin duhet të vendosë kufizime të personave që mund të vizitojnë mjediset e shërbimit, sa njerëz mund të vizitojnë njëherazi, çfarë mund t'u lejohet vizitorëve që të bëjnë dhe sa shpesh do të lejohen vizitorët. Rregullat për vizitat duhet të jenë të shkruara dhe të jenë afishohen në mënyrë publike.

4. Procedura e ankimit të përfituesit të mitur

4.1. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin siguron një procedurë legjitime dhe funksionale për ankimet. Përfituesi, prindërit ose personi i afërt i të miturit mund të ankohet rreth çdo aspekti të jetesës në këtë shërbim, si dhe për shërbimet që ka marrë ose jo.

4.2. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet t'i konsiderojnë këto ankesa si një mundësi për të përmirësuar performancën e tij. Asnjë pasojë negative nuk mund të ketë për përfituesin për shkak të paraqitjes së një ankese.

4.3. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin zbaton procedura të qarta me shkrim për trajtimin e ankesave. Këto procedura duhet të shpjegojnë mënyrat e ndryshme të ankimimit që mund të përdoren nga përfituesi.

4.4. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin mban një regjistër ankesash. Në këtë regjistër duhet të përfshihet personi përgjegjës për t'ju përgjigjur ankesës, rezultatet nga hetimi i ankesës, si është trajtuar ankesa dhe dokumentacion të shkruar mbi përgjigjen që i është dhënë personit që ka bërë ankesën, nëse ankesa nuk është anonime.

4.5. Çdo anëtar i personelit të ofruesit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin që merr një ankesë verbale nga një përfitues, duhet ta regjistrojë këtë ankesë në regjistrin e ankesave, së bashku me datën e ankesës, dhe të dokumentojë mënyrën se si është trajtuar ankesa.

4.6. Të gjitha ankesat duhet të marrin përgjigje me shkrim dhe një kopje e përgjigjes me shkrim përfshihet në regjistrin e ankesave.

5. Vlerësimi i shërbimit të ofruar

5.1. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin i kërkon përfituesit të mitur, prindërve apo personit të afërt të të miturit të plotësojnë në mënyrë anonime formularin e vlerësimit të shërbimit. Në formular ata vlerësojnë shërbimet e ofruara, në mënyrë që shërbimet të përmirësohen sipas nevojave. Formulari plotësohet çdo tre muaj ose dhe më shpesh, në rastet kur janë ndërmarrë veprime për të trajtuar ankesat, opinionet dhe sugjerimet ndaj shërbimeve të ofruara.

5.2. Në momentin e përfundimit të shërbimit të specializuar, i mitur përfitues duhet të plotësojë formularin e vlerësimit para largimit.

5.3. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të ndjekur përfituesit rregullisht edhe pas largimit të tyre nga shërbimi, për një periudhë nga 6 muaj deri në 2 vjet. Monitorimi mund të bëhet nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit, siç janë telefonat, korrespondenca elektronike, si dhe me mjete të tjera komunikimi.

5.4. Ministria e Drejtësisë dhe ministria që ka në fushën e përgjegjësisë së saj mbrojtjen sociale të fëmijëve nxjerrin udhëzime të përbashkët për përcaktimin e metodologjisë dhe standardeve të vlerësimit të shërbimit të ofruar.

5.5. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin raporton, çdo tre muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve pranë Ministrisë së Drejtësisë.

5.6. Ministria e Drejtësisë paralelisht, monitoron ofrimin e shërbimeve të specializuara për të miturit në konflikt me ligjin, sipas standardeve e treguesve të performancës, përcaktuar në marrëveshjen kontraktuale dhe sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse.

6. Bashkëpunimi në rrjetet me struktura dhe shërbime të tjera të specializuara për të miturit

6.1. Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin bashkëpunojnë me strukturat dhe shërbimet e tjera, duke siguruar ndjekjen e ecurisë dhe plotësimin e nevojave të përfituesit dhe rikthimin e tyre në shoqëri.

6.2. Çdo ofrues shërbimesh i specializuar për të miturit në konflikt me ligjin zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe organizata, me qëllim ofrimin e shërbimeve specifike, si me klinika mjekësore apo spitale, me institucione arsimore dhe me institucione të tjera sipas specifikës së ofruar; ose me njësitë e vetëqeverisjes vendore apo organizatat jofitimprurëse në nivel vendor për të realizuar një ose disa shërbime të caktuara.

6.3. Në çdo rast, ofruesi i shërbimit duhet të marrë paraprakisht pëlqimin e Ministrinë e Drejtësisë dhe e mban atë të informuar për ecurinë e bashkëpunimit.

III. RREGULLAT E PROGRAMEVE

1. Vlerësimi i Nevojave

1.1. Nevojat e të miturit në konflikt me ligjin që vendoset në shërbimin e specializuar vlerësohen nga një ekip multidisiplinar që ngrihet nga ofruesi, të cilët punojnë së

bashku për të trajtuar rastin në përputhje me moshën dhe nevojat, me qëllim hartimin e planit individual të mbikëqyrjes.

1.2. Për çdo përfitues të mitur caktohet një punonjës social, i cili menaxhon rastin. Menaxheri i rastit udhëheq procesin e vlerësimit të nevojave të përfituesit, hartimin e planit të mbikëqyrjes dhe zbatimin e tij. Ai takohet rregullisht me përfituesin e mitur për të diskutuar progresin e përgjithshëm në arritjen e qëllimeve individuale dhe planit të mbikëqyrjes. Ai ndihmon përfituesin e mitur për të identifikuar dhe arritur burimet e nevojshme.

1.3. Vlerësimi i nevojave përfshin:

- i) vlerësimin e nevojave shëndetësore,
- ii) vlerësimin e nevojave psikosociale,
- iii) vlerësimin e nevojave ligjore,
- iv) vlerësimin e nevojave arsimore,
- v) vlerësimin e nevojave profesionale,
- vi) vlerësimin e nevojave të punësimit,
- vii) vlerësimin e nevojave të sigurisë,
- viii) vlerësimin e nevojave të lidhjeve me familjen dhe komunitetin;
- ix) vlerësimin e nevojave të tjera sipas rastit specifik.

1.4. Vlerësimi i nevojave individuale për përfituesin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të përfundojë brenda 3 (tre) ditëve nga data referimit të të miturit për t'u vendosur në shërbimin e specializuar.

1.5. Pasi kryhet vlerësimi i nevojave, ekipi multidisiplinor mblidhet për të vlerësuar rastin dhe për të hartuar planin përkatës të mbikëqyrjes së të miturit.

2. Planifikimi i mbikëqyrjes

2.1. Plani i mbikëqyrjes hartohet pas vlerësimit të nevojave dhe përfshin masat afatmesme dhe afatgjata të nevojave të identifikuara për përfituesin e mitur në konflikt me ligjin.

2.2. Plani i mbikëqyrjes hartohet brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendosjes së të miturit në konflikt me ligjin në shërbimin e specializuar.

2.3. I mituri në konflikt me ligjin përfitues përfshihet në procesin e hartimit të planit të mbikëqyrjes në përputhje me grupmoshën, kapacitetin dhe aftësitë individuale.

2.4. Menaxheri i rastit është përgjegjës për mbledhjen e informacionit dhe hartimin e planit të mbikëqyrjes. Menaxheri i rastit bashkëpunon me ekipin multidisiplinor.

2.5. Për përfituesin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin hartohet plani i mbikëqyrjes të përshtatur me nevojat e tij, në përputhje me standardet e shërbimeve të perkujdesjet shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale.

2.6. Plani i mbikëqyrjes përditësohet e përshtatet me ndryshimet e nevojave dhe rrethanave të përfituesit. Menaxheri e rastit dhe përfituesi duhet të takohen për të diskutuar progresin e bërë deri në atë moment dhe ndonjë ndryshim të nevojshëm të planit.

2.7. Nëse përfituesi transferohet në një shërbim tjetër të specializuar për të miturit, një kopje e planit të mbikëqyrjes duhet t'i dërgohet ofruesit të ri të shërbimit, në mënyrë që ndihma e filluar të vazhdojë të ofrohet si dhe ofruesi i ri të kuptojë se cilat shërbimet i janë ofruar përfituesit deri në atë moment.

IV. RREGULLAT PËR FINANCIMIN

1. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin duhet të ketë buxhet të përshtatshëm për të realizuar shërbimet e planifikuara.
2. Ministria e Drejtësisë vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimit të specializuar për të miturin në konflikt me ligjin, në përputhje me planet strategjike të zhvillimit dhe me programin buxhetor afatmesëm.
4. Ministria e Drejtësisë vlerëson kapacitetet financiare dhe burimet njerëzore që mbështesin ofrimin e shërbimeve të specializuara për të miturin në konflikt me ligjin.
5. Ministria e Drejtësisë parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të specializuara për të miturin në konflikt me ligjin, të cilat u transferohen ofruesve të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje.
6. Ministria e Drejtësisë prokuron shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin por që nuk mund të ofrohen prej institucioneve, dhe mund të ofrohen nga personat juridikë të licencuar që operojnë në këtë fushë private.
7. Ministria e Drejtësisë prokuron shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin dhe lidh kontratat me ofruesit e shërbimit, duke u dhënë përparësi ndërmarrjeve sociale në ofrimin e këtyre shërbimeve.
8. Ofruesit e shërbimit të specializuar, të kontraktuar nga Ministria e Drejtësisë dhe organizatat jofimprurëse ofrojnë shërbimet e specializuara për të miturit, si pjesë e kontratës ose e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet palëve.

V. RREGULLA TË FUNDIT

1. Në rastet kur ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin nuk është më i aftë të vijojë veprimtarinë, drejtuesi informon menjëherë Ministrinë e Drejtësisë për të siguruar një ofrim të pandërprerë të shërbimit për të miturin.
2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

